



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr. 51 datë 27.9.2022

**“PËR MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË VKB NR.19, DATË 10.05.2022 “PËR
MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË FUNKSIONARËVE TË ZGJEDHUR
OSE TË EMËRUAR, TË NËPUNËSVE CIVILË E TË PUNONJËSVE
ADMINISTRATIVË TË BASHKISË SHKODËR DHE INSTITUCIONEVE TË
VARËSISË”**

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës 27.9.2022, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1.1, shkronja “b”, të nenit 51 pika 1, të nenit 54 shkronja “ç”, të nenit 55 pika 2, të nenit 71 pika 6 të Ligjit nr.139 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; Ligjit nr.44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurës Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Ligjit nr.10405, date 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”; ligjit nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022” i ndryshuar; Vendimit të KB nr.19, datë 10.05.2022 “Për miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të Bashkisë Shkodër dhe institucioneve të varësisë”, Vendimit të KB nr.3, datë 05.01.2022 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2022 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2022-2024 të Bashkisë së Shkodrës” i ndryshuar; VKM nr. 175 dt. 08.03.2017 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë, në arsimin parauniversitar” i ndryshuar me VKM nr. 465, datë 6.7.2022, relacionit të administratës së Bashkisë Shkodër,

V E N D O S I:

1. Miratimin e ndryshimit të VKB nr.19, datë 10.05.2022 “Për miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të Bashkisë Shkodër dhe institucioneve të varësisë” sa i

përket nivelit të pagave të punonjësve mësimorë në arsimin parashkollor dhe drejtuesit në institucionet parashkollor , të qendrave kulturore të fëmijëve dhe konvikteve të nxënësve ” sipas tabelës nr. 3 bashkëlidhur.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

KRYETAR



Sekretari i Këshillit Bashkiak

A blue ink signature of Denis Lesha.

Denis Lesha

Miratuar me 31 vota

Vota Pro 31

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 30.9.2022

Ishte**Niveli i pagave të punonjësve mesimor, në arsimin parauniversitar****Tab .3**

Emërtimi	Arsimi i lartë		Vjetërsia
	Kategoria	Pozicioni	Shtesa për vjetërsi, në përqindje
Drejtor i Qendrës Kulturore të Fëmijëve	1	58650	2%
Përgjegjës sektori në Qendrën Kulturore të Fëmijëve	1	50600	2%
Instruktor në Qendrën Kulturore të Fëmijëve	1	48900	2%
Drejtor i kopshtit me ushqim	1	51750	2%
Drejtor i kopshtit pa ushqim	1	48900	2%
Edukator në kopsht fëmijësh	1	42200	2%
Edukator në kopsht fëmijësh	2	39100	2%
Drejtor i konvikteve	1	70150	2%
Edukator konvikti/ Kujdestar konvikti	1	45200	2%
Edukator konvikti/ Kujdestar konvikti	2	42200	2%

Behet**Niveli i pagave të punonjësve mesimor, në arsimin parauniversitar****Tab .3**

Emërtimi	Arsimi i lartë		Vjetërsia
	Kategoria	Pozicioni	Shtesa për vjetërsi, në përqindje
Drejtor i Qendrës Kulturore të Fëmijëve	1	62200	2%
Përgjegjës sektori në Qendrën Kulturore të Fëmijëve	1	53700	2%
Instruktor në Qendrën Kulturore të Fëmijëve	1	51900	2%
Drejtor i kopshtit me ushqim	1	54900	2%
Drejtor i kopshtit pa ushqim	1	51900	2%
Edukator në kopsht fëmijësh	1	44800	2%
Edukator në kopsht fëmijësh	2	41500	2%
Drejtor i konvikteve	1	74400	2%
Edukator konvikti/ Kujdestar konvikti	1	48000	2%
Edukator konvikti/ Kujdestar konvikti	2	44800	2%